REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2023)

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2018 – 2020, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë", (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:34 dhe mbaroi në orën 13:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
7. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
8. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zoti Ridvan Hado***, ***zoti Dritan Hallunaj*** dhe ***zonja Marçela Shehu***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Maela Alicanaj dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

6. Të tjerë: Greta.

7. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2018 – 2020, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë", (relatore znj. Irena Plaku).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, sot në rendin e ditës kemi tre çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja e Këshillit.

Në fakt unë dua t'ju sjell në vëmendje lidhur me punën që ka bërë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për masat që po ndërmerr sa i përket gjykatave më në nevojë që ndodhen në këto momente, që është Gjykata e Tiranës dhe Gjykata e Durrësit, duke marrë parasysh përdorimin e të gjithë mekanizmave të nevojshëm, në mënyrë që qytetari të ketë shërbim sa më të shpejtë dhe cilësor në këto gjykata, për shkak të pasojave që ka lënë procesi i rivlerësimit kalimtar.

Pa humbur kohë po fillojmë me aktin e parë, i cili ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2018 – 2020, gjatë ushtrimit të detyrës si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Irena Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Shkurtimisht, meqenëse ju jeni njohur të gjithë me projektraportin e vlerësimit i cili është dërguar rishtazi, në kushtet kur gjyqtarja nuk ka kundërshtime në lidhje me këtë projektraport.

Atëherë, në mënyrë të përmbledhur, procedura e vlerësimit ka filluar me kërkesë të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë për konfirmimin e ndihmësmagjistrates për një periudhë tjetër trevjeçare.

Me shkresën e datës 18.12. KZHK–ja i kërkoi Komisionit të Vlerësimit kryerjen e procedurës. Procedura e vlerësimit ka filluar me vendimin nr. 441, të datës 01.11.2022.

Është kryer e gjithë procedura për njoftimin e magjistrates, kryerja e shortit për identifikimin e dosjeve për të cilën ka filluar procedura me qëllim vlerësimin e saj.

Më pas, pasi është konstatuar plotësia e dokumentacionit, me vendimin e datës 12.11.2022 të Komisionit është vendosur plotësimi i procedurës dhe është njoftuar projektraporti po atë ditë gjyqtares, e cila nëpërmjet e-mailit të po asaj dite, ka konfirmuar marrjen dijeni dhe ka deklaruar se nuk ka kundërshtime lidhur me projektraportin e vlerësimit.

Në mënyrë të përmbledhur do jap përfundimet lidhur me kriteret e vlerësimit dhe secilin tregues.

Konkretisht, për sa i përket kriterit "Aftësia profesionale të ndihmësmagjistrates", konkretisht për sa i përket treguesit "Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm.." është arritur në konkluzionin: referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka aftësi shumë të mira për identifikimin tepër të qartë, konciz dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe pasqyrimin e ecurisë procedurale të saj në gjykatat e faktit, duke integruar në këtë pjesë të relacioneve pjesët thelbësore të arsyetimit të këtyre gjykatave. Sa i përket identifikimit

të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në rastin konkret, rezulton të jetë bërë në shumicën e dokumenteve ligjore. Vetëm në tre relacione nuk rezulton i identifikuar ligji i zbatueshëm por edhe në këtë rast ligji është referuar tek pjesa e arsyetimit të vendimit të gjykatave të faktit. Përfundimisht është vlerësuar dhe propozohet aftësia e gjyqtares për këtë tregues si "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit "Aftësia për të interpretuar ligjin e zbatueshëm", është arritur në konkluzionin se referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues rezulton se ndihmësmagjistratja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në mbështetje të opinionit ligjor në lidhje me zgjidhjen e çështjeve konkrete të ngritura në rekurs. Ky interpretim evidentohet në shumicën prej dokumenteve ligjore të analizuara, ndërsa për shumë pak prej tyre, interpretimi i ligjit mungon, për shkak se çështja e ardhur për rekurs nuk janë shtruar për diskutim ligjor. Për sa më sipër, pas analizës së dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates për treguesin "Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes" duhet të vlerësohet si "shumë e lartë" duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit "Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit", nga tërësi e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja tregon kujdes të posaçëm për pasqyrimin qartë, konciz dhe të saktë të fakteve të çështjes, ecurisë procedurale të gjykimit, shkaqeve të rekursit dhe në arsyetimin ligjor të opinionit të saj drejtuar kolegjit. Në pjesën e mendimit të ndihmësit ligjor, rezulton e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të koncizitetit dhe kuptueshmërisë të mendimit të ndihmësit ligjor lidhur me zgjidhjen e çështjes apo evidentimin e çështjeve për diskutim para kolegjit. Në këto kushte, pas analizës së të dhënave, edhe për këtë tregues, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates është "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket treguesit "Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentit ligjor", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të dokumentit ligjor, pavarësisht

përmbajtjes që ka secila ndarje. Në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e dokumentit ligjor në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin. Edhe për këtë tregues vlerësohet se aftësia e gjyqtares është "shumë e lartë", duke propozuar pikëzimin e saj me 10 pikë.

Për sa i përket treguesit "Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik", referuar burimeve të vlerësimit është arritur në konkluzionin se edhe pse në disa prej dokumenteve ligjore të analizuara më sipër, nuk evidentohet e njëjta shkallë analize dhe argumentimi logjik, pasi në disa prej tyre komponenti analitik bazohet kryesisht në konkluzionin mbi zgjidhjen e çështjes, pa u shoqëruar me një analizë paraprake se pse fakte të caktuara çojnë në këtë përfundim ligjor, atje ku vërtet ngrihen probleme ligjore, konstatohet se ndihmësmagjistratja bën një analizë të detajuar dhe të mirëorganizuar të çështjes. Duke analizuar të gjithë metodologjinë e punës së ndihmësmagjistrates, e vlerësuar kjo bashkë me mendimin e kolegjit për vlerësimin e punës së ndihmësmagjistrates, vlerësoj se aftësia për këtë tregues është "shumë e lartë", dhe për këtë arsye duhet të pikëzohet me 25 pikë.

Kështu, propozimi sa i përket kriterit "Aftësia profesionale e ndihmësmagjistrates" është "Shkëlqyeshëm", duke e pikëzuar me 100 pikë.

Sa i përket "Aftësisë organizative të ndihmësmagjistrates", konkretisht për treguesin "Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë", "Treguesi sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore", në tërësi, referuar që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka përgatitur për relatim mesatarisht rreth 20 çështje në muaj, duke qenë sa standardi sasior në fuqi. Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e ndihmësmagjistrates për këtë tregues është "në standard", duke e pikëzuar me 10 pikë.

Sa i përket "Rendimentit të përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore", duke qenë se siç e kam theksuar në projektraport që nuk ka të dhëna për sa i përket çështjeve të caktuara dhe çështjeve të cilat ajo ka përfunduar, konkluzioni është arritur vetëm mbi ato çështje të cilat ka përfunduar, duke konsideruar që kanë qenë në standard. Referuar kushteve të punës e shkallës së angazhimit të ndihmësmagjistrates në

detyra të tjera, veç atyre të trajtimit të çështjeve gjyqësore, vlerësoj se pikëzimi për këtë tregues duhet të jetë në nivelin maksimal prej 15 pikëve.

Sa i përket "Aftësisë për të përfunduar në kohë çështjet e ngarkuara", "Respektimi i standardeve minimale kohore", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, në mungesë të standardeve minimale kohore të miratuara brenda të cilave duhet të përgatitej dokumenti ligjor nga ndihmësmagjistratja në periudhën e vlerësimit, si dhe kohës mesatare të përgatitjes së relacioneve, pasi nga statistikat nuk ka një të dhënë të tillë (data e caktimit të çështjes për relatim dhe momenti kur është bërë relatimi), vlerësoj se aftësia e ndihmësmagjistrates për këtë tregues është "shumë e lartë" dhe duhet të pikëzohet maksimalisht me 15 pikë.

Sa i përket "Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje", në mungesë të të dhënave të sakta për të përllogaritur kohën e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor, si dhe vlerësimit maksimal të Kolegjit Civil lidhur me treguesin e shpejtësisë për ndihmësmagjistraten {...}, vlerësohet se aftësia për këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht me 20 pikë.

Sa i përket treguesit "Aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor", duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi dhe mungesës së të dhënave konkrete lidhur me veprimet procedurale të kryera nga ndihmësmagjistratja në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit, në funksion të organizimit të procesit gjyqësor për çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, vlerësohet se aftësia e ndihmësmagjistrates për këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht me 15 pikë.

Në lidhje me treguesin "Aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relatim, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi, për shkak të kërkesave procedurale", në tërësi duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi, vlerësimit të Kolegjit dhe të dhënat për dy çështje e cila përbën çështje me përparësi në trajtim, prezumohet se ndihmësmagjitratja ka treguar aftësi shumë të larta në evidentimin dhe përgatitjen për relatim të të gjitha çështjeve të kësaj natyre. Për këtë arsye, vlerësohet se

aftësia e saj për këtë tregues është shumë të lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht me 10 pikë.

Sa i përket treguesit “Rregullshmëria, saktësia e plotësia e dosjes gjyqësor”, në konkluzion, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se aktet e dosjes gjyqësore janë të rregullta dhe të sakta, por në 2 raste janë të paplota, pasi në 2 dosjet e përzgjedhura me short mungon dokumenti ligjor (relacioni) i përgatitur nga ndihmësi ligjor. Për këtë arsye, vlerësohet se shkalla e aftësisë së saj është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 10 pikë.

Për kriterin e “Aftësive organizative” është propozuar niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikëzimi me 95 pikë.

Sa i përket “Etikës dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion”, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja gjatë ushtrimit të funksionit të ndihmësmagjistrates në Gjykatën e Lartë, ka reflektuar angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë e saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se ndihmësmagjistratja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion dhe propozohet pikëzimi i saj me 35 pikë.

Sa i përket treguesit “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e ndihmësmagjistrates. Për këtë arsye, për këtë tregues propozohet pikëzimi i saj me 40 pikë.

Për sa i përket treguesit “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin verbal ose në përmbajtjen e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se ndihmësmagjistratja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e

gjuhës diskriminuese. Aftësia e saj për këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 10 pikë.

Sa i përket "Numrit tejet të lartë të kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari", për këtë tregues vlerësohet se nuk ka rezultuar asnjë kërkesë për heqje dorë. Për këtë arsye vlerësohet se numri i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari duhet të vlerësohet si "I pakonsiderueshëm", duke qenë se nga të dhënat burim vlerësimi rezulton se nuk ka asnjë kërkesë të paraqitur për heqje dorë nga përgatitja e dokumenteve ligjore për çështjet e caktuara, e për rrjedhojë, asnjë kërkesë të refuzuar nga kryetari. Kështu edhe për këtë tregues propozohet pikëzimi i saj me 15 pikë.

Në tërësi, kriteri "Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale" propozohet niveli "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë.

"Aftësia personale dhe angazhimi profesional", sa i përket treguesit "komunikimi i qartë dhe transparent", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka komunikim të qartë dhe transparent në komunikimin verbal, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Për këtë arsye, pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates për këtë tregues është "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit "Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale", referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se ndihmësmagjistratja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit. Në këto kushte, për këtë tregues vlerësohet se aftësia e gjyqtares është "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket "Aftësisë për të bashkëpunuar", konkretisht "Gatishmëria dhe shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta", referuar burimeve të vlerësimit, ndër të cilat është marrë parasysh edhe mendimi i kolegjit edhe i zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë,

rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë. Për këtë arsye aftësia e saj është vlerësuar "shumë e lartë" duke e pikëzuar me 10 pikë.

"Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga organet drejtuese të gjykatës", edhe për këtë tregues është arritur në konkluzionin se referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e ndihmësmagjistrates në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga organet drejtuese, vlerësoj se aftësia e saj në lidhje me këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Sa i përket treguesit "Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje", referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues vlerësohet se shkalla e bashkëpunimit dhe aftësia për të reaguar me efikasitet në rast nevoje për ndihmësmagjistraten {...} është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht me 10 pikë.

Sa i përket treguesit "Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera", "Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të shkollës së magjistraturës dhe në trajnime të tjera", referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se ndihmësmagjistratja, gjatë periudhës së vlerësimit 2018-2020 është ftuar dhe ka marrë pjesë në cilësinë e pjesëmarrësit dhe lehtësuesit në aktivitetet trajnuese në një numër të konsiderueshëm rreth 11 aktivitete trajnuese, 3 si pjesëmarrëse dhe 8 si lehtësuese, me një numër ditësh 33 ditësh.

Gjithashtu subjekti i vlerësimit ka deklaruar se ka marrë pjesë edhe në trajnime të tjera duke paraqitur edhe dokumentacion provues në tre aktivitete të tjera jashtë Shkollës së Magjistraturës, konkretisht të zhvilluar jashtë shtetit, 2 në Budapest dhe 1 në Vjenë (Austri).

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka marrë pjesë në 14 aktivitete trajnuese, brenda programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë tij, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 39 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve ligjorë, sipas parashikimeve të nenit 5 të ligjit nr.96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve", kështu për këtë

tregues, duke qenë se numri i trajnimeve është brenda 15-120 ditëve, propozohet pikëzimi i saj me 20 pikë.

Sa i përket "Disponueshmërisë së ndihmësmagjistrates për trajnimin e gjyqtarëve", referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se ndihmësmagjistratja, përgjatë periudhës së vlerësimit viti 2018-2020, ka marrë pjesë në 8 (tetë) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e lehtësuesit. Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të ndihmësmagjistrates, të gjithë ndihmësmagjistratët do ta fillojnë vlerësimin për ketë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, në kushtet kur rezultoi që ndihmësmagjistratja ka marrë pjesë në aktivitete të trajnimit të gjyqtarëve, vlerësoj se pikëzimi i saj për këtë tregues duhet të jetë me 5 pikë.

Sa i përket treguesit "Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë", referuar burimeve të vlerësimit ka rezultuar se ndihmësmagjistratja, konkretisht referuar vërtetimit {...} prot., datë 11.01.2023 është përfshirë në procesin e mësimdhënies në ciklin e studimeve "bachelor" dhe "master" pranë Universitetit "Tirana Business". Për këtë arsye, në kushtet kur rezultojnë të dhëna për angazhimin e kësaj gjyqtareje, vlerësohet se pikëzimi i saj duhet të jetë 5 pikë për shkak se kanë rezultuar të dhëna.

Sa i përket treguesit "Publikime ligjore akademike", referuar burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, në lidhje me angazhimin e ndihmësmagjistrates në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, rezulton se gjatë viteve 2018 -2020 ndihmësmagjistratja ka publikuar 2 artikuj shkencorë të botuar në Revistën "Avokatia", një në vitin 2018 dhe një në vitin 2020.

Për këtë arsye, duke qenë se rezulton se ndihmësmagjistratja ka publikime, propozohet pikëzimi i saj me 5 pikë.

Në tërësi, edhe për kriterin "Aftësia personale dhe angazhimi profesional i ndihmësmagjistrates" propozohet vlerësimi "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë.

Në tërësi, referuar 4 kritereve të vlerësimit të gjyqtares:

Për kriterin e parë propozohet vlerësimi "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë.

Për sa i përket “Aftësisë organizative të ndihmësmagjistrates” propozohet vlerësimi "Shkëlqyeshëm" me 95 pikë.

Për sa i përket kriterit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë.

Në kriterin “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, me 100 pikë, vlerësimi "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit "Shkëlqyeshëm" me pikëzimin prej 395 pikë.

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja/ ndihmësmagjistratja {...} të vijojë të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Plaku!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, do kalojmë në votim.

Përpara se të kalojmë në votim, dëshiroj të informoj se zonja Marçela Shehu e ka në pamundësi sot të jetë, pasi është në një angazhim si gjyqtare e medias. Gjithashtu edhe zoti Hado dhe zoti Hallunaj janë duke hedhur shortin për çështjet e rivlerësimit kalimtar. Kështu që nuk janë prezent në mbledhje.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2018 – 2020, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";

B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shkëlqyeshëm".

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2023)

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

2.1 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares Gilda Hoxha për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

2.2 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares Lorena Çabej për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

2.3 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares Marçela Shehu për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

2.4 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.5 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.6 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.7 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.8 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.9 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.10 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
2.11 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
2.12 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
2.13 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
2.14 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
2.15 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
2.16 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
2.17 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
2.18 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura;
2.19 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura;
2.20 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.
2.21 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.
2.22 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.
2.23 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.
2.24 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

2.25 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:34 dhe mbaroi në orën 13:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
7. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
8. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zoti Ridvan Hado***, ***zoti Dritan Hallunaj*** dhe ***zonja Marçela Shehu***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Maela Alicanaj dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

6. Të tjerë: Greta.

7. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

2.1 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares Gilda Hoxha për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

2.2 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares Lorena Çabej për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

2.3 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares Marçela Shehu për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

2.4 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.5 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.6 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.7 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.8 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.9 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.10 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.11 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.12 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.13 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
2.14 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
2.15 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
2.16 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
2.17 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
2.18 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura;
2.19 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura;
2.20 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.
2.21 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.
2.22 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.
2.23 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.
2.24 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.
2.25 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt–aktin e dytë.

Ashti siç e përmenda, bëhet fjalë për një studim, i bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i cili passjell edhe disa projektvendime që i propozohen Këshillit për të

zhbllokuar situatën në dy gjykatat më në nevojë që ndodhen këto momente, që është Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata e Shkallës së Parë Durrës. Për më shumë detaje, ia jap fjalën relatorit, zotit Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Ashtu siç thatë edhe juve, gjendja e funksionalitetit të dy gjykatave, gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës ka qenë një shqetësim i përhershëm i KLGJ-së i cili nuk mund të riparohej për shkak edhe të mungesës së vazhdueshme që kemi pasur në burimet njerëzore, në trupat gjyqësore, në gjithë Republikën e Shqipërisë. Gjithsesi, nga ana e Komisionit është punuar dhe aktualisht është përgatitur një material ku janë parashikuar disa instrumente të cilat synojnë në kohë afatgjatë por edhe afatshkurtër të mundojnë përmirësimin sado pak të funksionalitetit të këtyre gjykatave.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 147 të Kushtetutës ka përgjegjësi jo vetëm për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, por ka përgjegjësi për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij, kjo e fundit tregues i qartë i përgjegjësive në fushën e statusit të gjyqtarëve. Më tej, Ligji nr. 96/2016 e ka përcaktuar Këshillin e Lartë Gjyqësor si organin më të lartë përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin, si dhe në mënyrë të veçantë, ka parashikuar procedura të veçanta kur konstaton pozicione të lira, pas çdo kontrolli tremujor të kryer me qëllim konstatimin e tyre. Për më tepër në nenin 89, pika b, Këshilli ka detyrimin të monitorojë ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve me qëllim përmirësimin e produktivitetit të tyre në mënyrë që parimi "gjykimi brenda një afati të arsyeshëm" të mos konvertohet në "drejtësi e vonuar, drejtësi e mohuar".

Për shkak të aplikimit të Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", burimet gjyqësore të trupave gjyqësore në të gjitha niveleve në Republikën e Shqipërisë kanë pësuar ulje drastike duke krijuar vakanca të përhershme në mënyrë sistematike.

Një nga këto gjykata, ku së fundmi pasqyrohet në përpjesëtim të zhdrejtë rritja e numrit të konflikteve gjyqësore dhe pakësimi drastik i numrit të trupës gjyqësore, duke shkaktuar një rritje të ndjeshme dhe të papërballueshme të ngarkesës së trupës gjyqësore dhe cenuar në këtë mënyrë funksionalitetin e saj, është edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj se, sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 7818, datë 16.11.2012, i ndryshuar, kjo gjykatë është parashikuar me një strukturë organizative me 76 gjyqtarë, ndërkohë që organika në fakt është 54 dhe efektivisht në detyrë janë 36, pra më pak se gjysma.

Bashkëlidhur në mënyrë tabelare ju kam paraqitur strukturën organizative të kësaj gjykate, numrin e gjyqtarëve sipas organikës në fakt dhe numrin e gjyqtarëve efektivisht në detyrë, ku aktualisht gjykata e rrethit Tiranë rezulton të ketë 40 pozicione të lira, nga të cilat 18 të përkohshme dhe 22 të përhershme, referuar kjo tabelës dhe pasqyrimit më poshtë të përcjellë nga Zyra e Burimeve Njerëzore pranë KLGJ-së (e përditësuar).

Vlen të përmendet se, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë aktualisht janë në detyrë vetëm 36 gjyqtarë, nga 76 të tillë sipas organikës së kësaj gjykate. Aktualisht ngarkesa e çështjeve gjyqësore pranë kësaj gjykate është si vijon më poshtë:

Në total është diku tek 19.374, Numri i çështjeve në shqyrtim 20.299; Numri i çështjeve të gjykuara 28.098 dhe numri i çështjeve të regjistruara (nga data 1 janar) aktualisht 29.020, që do të thotë, një numër i konsiderueshëm çështjesh e krahasuar këto me gjykatat e apelit.

Aktualisht, ngarkesa e gjyqtarëve në këtë gjykatë varion minimalisht për gjyqtarë, nga 105 çështje (dhoma penale) në maksimalisht në 1.533 çështje për gjyqtar në dhomën civile, ndërkohë nga kjo gjykatë për periudhën janar 2022 e në vijim nuk janë paraqitur kërkesa për caktim gjyqtari në çështje të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksione në mënyrë të përhershme, por nga ana tjetër janë shfrytëzuar burimet njerëzore të kësaj gjykate për të plotësuar trupat gjyqësore në gjykata të tjera. Parashikimi, duke u mbështetur në historikun dhe përvojën e deritanishme në lidhje me stabilizimin e situatës nuk është optimist.

E njëjta sinoptikë pesimiste vlen edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për të cilën janë administruar të dhënat e mëposhtme.

Sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 7818, datë 16.11.2012, i ndryshuar, struktura organizative është 17 gjyqtarë, organika në fakt 11 gjyqtarë; efektivisht 7 gjyqtarë.

E njëjta panoramë është paraqitur në formë tabelare.

Sa më sipër, aktualisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka gjithsej 10 (dhjetë) pozicione të lira, nga të cilat 4 (katër) të përkohshme dhe 6 (gjashtë) të përhershme, referuar kjo tabelës së marrë dhe përditësuar nga burimet tona njerëzore pranë KLGJ-së.

Vlen të përmendet se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës aktualisht janë në detyrë vetëm 7 gjyqtarë, nga 17 të tillë sipas organikës së kësaj gjykate. Aktualisht ngarkesa e çështjeve gjyqësore për gjyqtar, paraqitet në përputhje me tabelën që unë ju kam paraqitur, ku në total janë 2.364; Numri i çështjeve në shqyrtim 3.035; Numri i çështjeve të gjykuara 5.674; Numri i çështjeve të ardhura duke filluar nga data 1 janar 2023 është 6.345

Ndërkohë nga kjo gjykatë janë paraqitur për periudhën janar 2022 e në vijim, 3 kërkesa për caktim gjyqtari në çështje të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksione në mënyrë të përhershme nga të cilat janë plotësuar me 3 gjyqtarë.

Mekanizmat ligjorë për plotësimin e pozicioneve të lira të përhershme e atyre të përkohshme në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës:

Me qëllim që të stabilizohet dhe të parandalohet cenimi i mëtejshëm i funksionalitetit të këtyre Gjykatave duke përfshirë edhe efektet që rrjedhin nga aplikimi i Ligjit nr. 84/2016 dhe vazhdimi i krijimit të vakancave të tjera të përkohshme dhe të përhershme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka vlerësuar t'i propozojë Këshillit, mjetet efikase dhe ligjore që do të mund të stabilizojnë funksionalitetin, tashmë të cenuar të këtyre gjykatave.

Në këtë kuadër, nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, është vlerësuar dhe do të propozohet një zgjidhje afatgjatë, që do të kërkojë disa kohë për mbarimin e saj, pasi interferohet me procedurat e vlerësimit të gjyqtarëve dhe nuk do të mund të

konsiderohet si mjeti më efikas i stabilizimit të funksionalitetit të gjykatave. Sjell në vëmendjen tuaj parashikimet e nenit 43 të cilat trajtojnë procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve.

Qëllimi i nenit 43 është të garantojë zhvillimin e procesit të lëvizjes paralele, si një nga format e transferimit të magjistratit, duke parashikuar rregulla që adresojnë si nevojat e sistemit të drejtësisë, ashtu edhe të drejtën e magjistratit për ecurinë në karrierë. Bazuar në parimet e parashikuara në nenin 42, ligjvënësi ka synuar që nëpërmjet rregullave kryesisht procedurale në nenin 43, të garantojë qartësi dhe parashikueshmëri për transferimin e magjistratit në procedurën e lëvizjes paralele, si një nga mjetet standarde të lëvizjes së gjyqtarëve brenda të të njëjtit nivel.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i detyruar të vlerësojë, periodikisht ose rast pas rasti, nevojën për plotësimin e vendeve të lira në gjykata duke respektuar kushtet dhe parimet të parashikuara në nenin 42 lidhur me transferimin e magjistratit si dhe të rregullave të hollësishme që parashikon neni 43 për lëvizjen paralele. Gjithashtu magjistratët i nënshtrohen së pari renditjes së preferencës, parashikuar nga neni 42, pika 3 e Ligjit Për Statusin dhe rregullave lejuese e ndaluese që parashikohen në nenin 43, me qëllim plotësimin e vendeve të lira sipas një renditje të caktuar që respekton parimet e sanksionuara në nenin 42.

Qëllimi i nenit 42 është të garantojë se procesi i transferimit të përkohshëm ose të përhershëm të magjistratit, në pozicione të ndryshme brenda të njëjtit nivel ose të barasvlershëm me të, të bëhet jo vetëm sipas nevojave të sistemit të drejtësisë, por edhe në respektim të funksionit të magjistratit. Duke vendosur disa parime bazë, mbi të cilat kryhet transferimi, ligjvënësi synon së pari të disiplinojë këshillat në vendimmarrjen që lidhen me transferimin në pozicione të përhershme ose të përkohshme të magjistratëve sipas rregullave të parashikuara specifikisht dhe procedurave respektive. Së dyti, ai synon të ofrojë siguri, qartësi dhe parashikueshmëri për magjistratin, i cili mund t'i nënshtrohet lëvizjes në pozicion.

Më tej, pika 3 përcakton rrethanat dhe kategoria e magjistratëve që caktohen në një pozicion të lirë të përhershëm, konkretisht:

a) nga magjistrati që ka të drejtë të caktohet në nivel apeli;

b) nga magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive.

Në pikat 3 dhe 4 jepen kategoritë e magjistratëve, sipas radhës, që kanë të drejtë të transferohen në pozicionet e përkohshme dhe të përhershme. Konkretisht, radhën për plotësimin e pozicioneve të përhershme e kanë:

a) magjistrati që ka të drejtë të caktohet në nivel apeli;

b) magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimit të strukturës administrative;

c) magjistrati që transferohet sipas lëvizjes paralele;

ç) magjistrati që ka të drejtën e ngritjes në detyrë (pika 3).

Për plotësimin e pozicioneve të lira të përhershme Këshilli është i detyruar të respektojë radhën sipas shkronjave të mësipërme a); b); c) dhe ç). Në kushtet kur gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës janë gjykata të shkallës së parë, procedura e ngritjes në detyrë në këto gjykata nuk mund të aplikohet. Pozicionet e lira të përhershme në këto gjykata mund të plotësohen si rregull vetëm nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në rast se nuk ka magjistratë që duhet të transferohen pranë këtyre gjykatave sipas parashikimeve të shkronjave a) dhe b). Pas verifikimeve të kryera, ka rezultuar se aktualisht, Këshilli nuk ka detyrimin ligjor për të transferuar gjyqtarë sipas pikës a) dhe pjesërisht sipas b), në kushtet kur nuk rezulton të këtë gjyqtarë që "kanë të drejtë të caktohen në nivel apeli" apo "gjyqtarë që duhet të transferohen për shkak të papajtueshmërisë ambientale", ndërsa, në vlerësimin e këtyre kategorive, Komisioni ka konstatuar se në gjykatat e tjera të të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë, ka disa gjyqtarë pozicioni i së cilëve në strukturat e gjykatave ku ata janë caktuar në mënyrë të përhershme, është suprimuar. Këshilli ka detyrimin që para shpalljes së procedurave të lëvizjes paralele për plotësimin e pozicioneve të lira të përhershme në gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, duhet t'ia u ofrojë këto pozicione për të zgjedhur pikërisht këtyre gjyqtarëve.

Kjo e drejtë e gjyqtarëve, të cilët rezultojnë jashtë strukturës së trupës gjyqësore ku ata janë caktuar në mënyrë të përhershme, rrjedh nga nenet 138 dhe 145/1 të

Kushtetutës, si edhe ndër të tjera edhe nga nenet 42 pika 3/b, 44/b, 57 pika 3, 4 të Ligjit nr. 96/2016 të cilët garantojnë dhe sanksionojnë pavarësinë e jashtme dhe të brendshme të pushtetit gjyqësor, (pavarësia nga pushtetet e tjera dhe pavarësia gjyqësore individuale pasi gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve, kritere këto të detajuara edhe në vendimin nr. 40, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

Pavarësia individuale, sigurohet ndër të tjera edhe nga procedurat e emërimit, të promovimit të gjyqtarëve, bazuar mbi kualifikimin profesional dhe integritetit personal si edhe të detyrimit të ruajtjes të vendit të punës në momentin që ata ushtrojnë një detyrë tjetër në favor të sistemit të Drejtësisë.

Kuptimi dhe rëndësia e sistemit të garancive që lidhen me statusin e gjyqtarit është analizuar edhe më parë nga jurisprudenca kushtetuese, duke theksuar në këtë rast rëndësinë që ka ky sistem në kuadër të pavarësisë së gjyqtarit. Garancitë e sanksionuara nga dispozitat Kushtetuese u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në qëndrueshmërinë apo ruajtjen e pozicionit të funksionit apo elementë të tjera që burojnë nga ushtrimi i saj.

Nga aktet e administruara nga struktura e personelit pranë KLGJ-së, rezulton se gjykatat mbi organikë janë si vijon: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë; dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Natyrisht janë konstatuar edhe gjyqtarët përkatës dhe këtë kuadër, për ta, Komisioni i propozon Këshillit, bazuar në nenet 4 dhe 147/1/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016, në nenet 42/3B, 44, 53, pikat 6 dhe 7, si edhe në nenin 57, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016, transferimin e gjyqtarëve që rezultojnë jashtë strukturave organizative të gjykatave ku kanë emërimin e përhershëm, duke i ofruar këtyre gjyqtarëve të drejtën e zgjedhjes midis pozicioneve të lira të përhershme ne fushën e së drejtës civile e atë penale, në gjykatat e të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë, që për çka u analizua më lart janë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, gjykata këto të cilat për shkak të pozicioneve të shumta të lira të përhershme, janë të cenuara në funksionalitetin e tyre.

Pas kësaj faze, Komisioni, duke marrë në konsideratë situatën e pasqyruar më lart, në të cilën ndodhen sot, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit

Gjyqësor Durrës, do t'i propozojë Këshillit të shpallë hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për 10 pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile marre ne konsiderate ngarkesën e konsiderueshme te dhomës civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 4 pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në përputhje me nenin 43 e vijues të ligjit "Për statusin" dhe vendimin nr.320, datë 17.09.2020 "Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve".

Më tej, Komisioni duke vlerësuar se procedurat e lëvizjes paralele do të kërkojnë një kohë të caktuar, pasi janë të ndërlidhura dhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve që do të kandidojnë, propozon që njëkohësisht me hapjen e procedurave të lëvizjeve paralele të fillojnë edhe procedurat e transferimit të përkohshëm të parashikuar nga neni 46 i Ligjit Për Statusin, si një nga instrumentet më të shpejtë në kohë, që do të mund të stabilizojë funksionalitetin e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Durrës.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës klasifikohen si "gjykata në nevojë", në kuptim të shkronjës "a", pika 2, neni 3, të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit", miratuar me Vendimin nr. 23, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite: "... a) "Gjykatë në nevojë" nënkupton gjykatën në të cilën ka një ose disa pozicione të lira të përkohshme, situatë e cila cenon funksionimin normal të saj".

Në situatën që ndodhen të dyja gjykatat, Komisioni vlerëson se adresimi më i shpejtë në kohë i nevojave të saj mund të bëhet përmes transferimit të përkohshëm të një gjyqtari me pëlqimin e tij.

Sa i përket hapjes së procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në rastin konkret, Komisioni vlerëson se ekzistojnë dy kushtet që e lejojnë atë, përcaktuar ato në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 96/2016, sikundër edhe në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Rregullores së Transferimit të Përkohshëm.

Konkretisht, në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit për Statusin, dispozitë që rregullon pikërisht transferimin e përkohshëm të gjyqtarit, përcaktohet se: "1. Në rastin kur në

skemën e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm, Këshilli mund t'i kërkojë magjistratit në një nga gjykatat ose prokuroritë me ngarkesën më të ulët, i cili përmbush kriteret për t'u transferuar ose për t'u ngritur në detyrë në pozicionin përkatës, të japë pëlqimin që për një periudhë të caktuar të transferohet përkohësisht në atë pozicion. ...".

Në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Rregullores së Transferimit të Përkohshëm, përcaktohet se: "1. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarit kryhet vetëm kur nevoja e gjykatës nuk mund të plotësohet nëpërmjet skemës së delegimit. 2. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarit kryhet vetëm atëherë kur në gjykatën në të cilën do të transferohet ka të paktën një pozicion të lirë të përkohshëm".

Duke ardhur në rastin konkret, konstatohet se në skemën e delegimit nuk ka magjistratë të disponueshëm, pasi 11 gjyqtarët e caktuar tashmë në skemën e delegimit, për shkak të nevojave imediate në pikëpamje të funksionalitetit të disa gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, janë caktuar për të gjykuar për një periudhë 1-vjeçare pranë këtyre gjykatave.

Për rrjedhojë, nevojat e Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës nuk mund të plotësohen nëpërmjet skemës së delegimit.

Vlen të përmendet se nevojat Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës nuk mund të adresohen as nëpërmjet masave të tjera, sikurse janë ato sipas Vendimit të Këshillit nr. 30, datë 14.02.2019, "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme", pasi sipas këtij vendimi, mundësohet caktimi i gjyqtarëve në çështje gjyqësore të veçanta vetëm në kushtet e padisponueshmërisë ligjore të gjyqtarëve të asaj gjykate për gjykimin e tyre. Në rastin konkret nevoja është për gjykimin në vijimësi të çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës, pra për një periudhë të caktuar kohe dhe jo për çështje gjyqësore të veçanta. Lidhur me këtë moment mbahet parasysh rregullimi i pikës 2, të nenit 5, të rregullores së transferimit të përkohshëm, sipas të cilit: "Këshilli shtyn shpalljen e vendeve të lira për transferim kur çmon se nevoja në gjykatën në të cilën synohet transferimi nuk është emergjente. Këshilli konsideron edhe marrjen e masave të tjera për adresimin e nevojës në gjykatën në të cilën synohet transferimi".

Ndaj sa sipër, Komisioni vlerëson se për plotësimin e nevojave që paraqet gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës, Këshilli duhet të orientohet paralelisht edhe në përcaktimet e rregullores së transferimit të përkohshëm, duke hapur kryesisht procedurën e transferimit të përkohshëm në pozicionin e lirë të përkohshëm pranë kësaj gjykate, sikurse përcaktohet në pikën 1, të nenit 5, të rregullores së transferimit të përkohshëm, sipas të cilit: "Kur një gjykatë është në nevojë dhe në skemën e delegimit nuk ka gjyqtar të disponueshëm, mbi kërkesë të gjykatës në nevojë ose kryesisht, kur vlerëson se nevoja e gjykatës ekziston dhe plotësimi i saj mund të bëhet vetëm përmes transferimit të përkohshëm, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm që është i hapur për transferim dhe u bën thirrje gjyqtarëve për të dhënë pëlqimin". Në këtë optikë Komisioni propozon hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për 6 pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në fushën civile dhe 2 pozicione në fushën civile për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në këtë kuadër, propozimet nga KZHK-ja për mbledhjen plenare janë si më poshtë:

1. Fillimin e procedurës së transferimit për gjyqtarët që aktualisht rezultojnë jashtë strukturës organizative të gjykatave ku janë të caktuar në mënyrë të përhershme, duke iu kërkuar secilit gjyqtar të evidentuar më lart në relacion, të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë me pozicionin e mëparshëm, si më poshtë:

i) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës civile;

ii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës penale;

iii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës civile;

iv) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës penale.

Ky hap i parë që duhet të ndërmerret nga Këshilli përbën njëkohësisht zbatim të detyrimit ligjor të parashikuar nga nenet 42 pika 3 shkronja b) dhe 44 pika 2 shkronja b) të Ligjit " Për Statusin", i ndryshuar, dhe parakusht të zbatimit të dy mekanizmave të tjerë për plotësimin e vakancave të përkohshme e të përhershme që siç u argumentua më lart janë "Lëvizja paralele" dhe "Transferimi i përkohshëm". Projekt-aktet përkatëse në zbatim të këtij hapi të parë i bashkëngjiten këtij relacioni.

Ndërkohë, paralelisht nga ana e KZHK-së do ju paraqitet edhe një projektvendim dhe një relacion për ndërprerjen e komandimit të gjyqtarëve të caktuar në mënyrë të përhershme në këto gjykata, Tiranë dhe Durrës, me qëllim që të mund të stabilizohet sado pak funksionaliteti i gjykatave përkatëse dhe të ulet niveli i çështjeve në gjykim.

Si fazë e dytë: Fillimi i procedurës për lëvizjen paralele për 10 (dhjetë) pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për 4 (katër) pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas relacioneve e projektvendimeve që do ju paraqiten në vijimësi.

Njëkohësisht me fillimin e procedurave të lëvizjes paralele, fillimin e procedurave për transferimin e përkohshëm në 6 (gjashtë) pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në 2 (dy) pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Bashkëlidhur këtij relacioni po ju citoj projektvendimet, ku ju sugjerohet që të miratoni si më poshtë:

Projektvendimi i parë është për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarëve të cilët për shkak të suprimimit të pozicionit të tyre në gjykatën ku janë caktuar në mënyrë të përhershme, krijojnë detyrimin e Këshillit për t'i sistemuar në një gjykatë tjetër. Në këtë kuadër ju propozohet: Pra projektvendimi i parë, në dispozitivin e të cilit do të gjeni dhe ju sugjerohet të miratoni *(dhe bëhet fjalë për tre projektvendime)*:

1. Fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarëve për të cilët është konstatuar suprimimi i pozicionit të tyre, përkatësisht në gjykatat Dibër, Lushnjë, Kurbin, në të cilat ato janë caktuar në mënyrë të përhershme.

2. T'u kërkojë këtyre gjyqtarëve të ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes për t'u

transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë me pozicionin e mëparshëm, si më poshtë:

i) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës civile;

ii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës penale;

iii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës civile;

iv) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës penale.

3. E drejta e zgjedhjes sipas pikës 1 duhet të ushtrohet brenda 3 (tre) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarëve sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Projektvendimi i dytë të cilin ju sugjerohet të miratoni është dhe ka lidhje për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës, për 10 (dhe 4) pozicione të lira në fushën e së drejtës civile (të cilat janë të ndara në projekte të veçanta, pra janë 10 të tilla), në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

Hapja e procedurës se lëvizjes paralele dhe shpallja e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhe Durrës), për 10 (dhe 4) pozicione të lira në fushën e të drejtës civile.

2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për lëvizjen paralele në detyrë në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

II. Afati i kandidimit

3.Afati i kandidimit është deri më datë 01.02.2023.

III. Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit

4. Në procedurën e lëvizjes paralele sipas këtij vendimi mund të konkurrojë çdo gjyqtar që është në një pozicion në një gjykatë të shkallës së parë, në një pozicion të komanduar ose në skemë delegimi, i cili plotëson kriteret ligjore për lëvizjen paralele në pozicionin e lirë për të cilin është hapur procedura.

5. Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për lëvizjen paralele në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përcaktohen në nenin 8, pika 3, në nenin 43, pika 2, shkronja "a", "c" dhe pika 6, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si më poshtë:

a) Kandidati duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit;

b) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi;

c) Kandidati nuk duhet të jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

6. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur;

b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);

c) Fotokopje të kartës së identitetit;

ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

dh) fotokopje të vlerësimeve etike dhe profesionale, në rast se ka.

7. Dokumentacioni sipas pikës 6, të këtij vendimi, duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

IV. Procedura e lëvizjes paralele

8. Procedura e lëvizjes paralele zhvillohet në tre faza, si më poshtë:

a) në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kritereve ligjore të kandidimit;

b) në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar;

c) në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart.

9. Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

10. Pas vendimit të Këshillit sipas pikës 9, fillon faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, ku kandidatët që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, i nënshtrohen fillimisht procesit të verifikimit të plotësimit të kritereve ligjore të kandidimit sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të pikës 5, të këtij vendimi, proces ky që realizohet sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 320, datë 17.09.2020, "Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve".

11. Në rast se për pozicionin e lirë nuk ka kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale, ose kur kandidatët e kësaj kategorie tërhiqen nga kandidimi, ose kur ata nuk kualifikohen për mosplotësim të kritereve të kandidimit, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët që kanë apo mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional.

12. Nëse për të njëjtat arsye procedura e lëvizjes paralele nuk do të mund të vazhdojë edhe për kandidatët që kanë apo mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional, atëherë ajo do të vazhdojë për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional.

13. Për renditjen e kandidatëve të kualifikuar me vendim përfundimtar, në fazën e dytë të procedurës së lëvizjes paralele zbatohen rregullat sipas Kreut VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 320, datë 17.09.2020, përveç sa parashikohet ndryshe në "Dispozitat për periudhën kalimtare" sipas Kreut VIII të tij.

14. Për kandidatin e kualifikuar me vendim përfundimtar, me përjashtim të atij që përpara kandidimit ka qenë në një pozicion të komanduar në vitin e fundit kalendarik, fillon procesi i vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional sipas ligjit nr. 96/2016, i

ndryshuar dhe rregullave të parashikuara në nenin 22, Kreu V, të Vendimit të Këshillit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019, "Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve".

15. Për kandidatin që është në një pozicion të komanduar prej jo më pak se viti i fundit kalendarik nga momenti i kandidimit, si vlerësim etik dhe profesional konsiderohet ai i bërë nga institucioni ku kandidati është i komanduar. Në rast të mospasjes së një vlerësimi të tillë, mbi kërkesën e kandidatit, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional sipas nenit 49 të ligjit nr. 96/2016, Vendimit nr.102, datë 05.07.2019, "Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë" dhe Vendimit nr.209, datë 11.10.2019, "Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë", të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

16. Në fazën e tretë të procedurës së lëvizjes paralele, kandidati i renditur më lart transferohet në pozicionin e lirë me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky projekt vlen edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për këtë gjykatë.

Pas këtij procesi, instrumenti tjetër i cili është pak më i shpejtë dhe do të përmirësojë ndoshta funksionalitetin e dy gjykatave është edhe drafti për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës dhe shpalljen e kërkesave për kandidatura. Pikërisht, bëhet fjalë për 6 pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 2 pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, të cilat janë përpiluar në projekt draftet përkatëse për 8 pozicionet, pra respektivisht 6 në Tiranë dhe 2 në Durrës; në dispozitivin e të cilës ju sugjerohet, parashikohet:

I. Hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhe Durrës).

2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë, për transferim të përkohshëm me pëlqim në këto dy gjykata për të 8 pozicionet (pra 6 në Tiranë dhe 2 në Durrës).

3. Afati i paraqitjes së kërkesave për transferim të përkohshëm është deri më datë 01.02.2023.

4. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

a) Kërkesën për shprehjen e interesit për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Durrës);

b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit;

c) Fotokopjen e kartës së identitetit;

ç) Deklaratën "Për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm" sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

d) Vetëdeklarimin për mospasjen masë disiplinore në fuqi, zbatimi i të cilës mund të shmanget për shkak të transferimit, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

dh) Vetëdeklarimin për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Dokumentacioni sipas pikës 4 të këtij vendimi, duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (brenda datës 01.02.2023).

II. Informacion për kriteret dhe kohëzgjatjen e transferimit të përkohshëm me pëlqim

6. Kriteret e transferimit të përkohshëm me pëlqim janë si më poshtë:

a) Transferimi i përkohshëm nuk duhet të cenojë funksionimin e gjykatës ku kandidati ka caktimin e përhershëm;

b) Dobia e transferimit të përkohshëm duhet të jetë më e madhe se efekti negativ që shkaktohet në gjykatën ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm;

c) Kandidati nuk duhet të jetë i transferuar përkohësisht ose duke shërbyer në skemën e delegimit;

ç) Kandidati nuk duhet të jetë nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të transferimit të përkohshëm;

d) Kandidati nuk duhet të gjendet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

7. Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm me pëlqim është deri në një vit. Ky transferim mund të përsëritet.

8. Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm me pëlqim mund të përfundojë para afatit:

a) me kërkesë të gjyqtarit të transferuar përkohësisht, për shkaqe të justifikuara;

b) kur vazhdimi i transferimit të përkohshëm do të passillte cenim të funksionimit të gjykatës ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm;

c) kur dobia e transferimit të përkohshëm është më e vogël se efekti negativ i shkaktuar në gjykatën ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm;

ç) kur ndaj gjyqtarit të transferuar përkohësisht merret masë disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të transferimit të tij;

d) kur gjyqtari i transferuar përkohësisht jep dorëheqjen nga statusi i magjistratit;

dh) kur gjyqtari i transferuar përkohësisht largohet nga detyra.

9. Për shqyrtimin e kërkesave për transferim të përkohshëm me pëlqim, Këshilli i Lartë Gjyqësor ndjek procedurën e përcaktuar në vendimin e tij nr. 23, datë 07.02.2019, "Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit", i ndryshuar.

10. Transferimi i përkohshëm me pëlqim i gjyqtarit bëhet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Toro për relacionin dhe faleminderit Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për masat e propozuara!

Atëherë, i kalojmë në grup aktesh, sipas relatorit. Pra, grupi i parë i akteve ka të

bëjë me fillimin e procedurave të transferimit të tre gjyqtareve për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku janë caktuar në mënyrë të përhershme.

Jeni dakord me propozimet që ka sjellë relatori?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord me propozimet e bëra.

Edhe unë mund të them vetëm dy fjalë shumë të shkurtra.

Është një punë, siç e përmendi edhe Kryetarja, e bërë nga Komisioni, për të marrë masa konkrete për të vënë në efiçencë gjykatën e Tiranës dhe gjykatën e Durrësit, si gjykatat më të mëdha. Është një punë e menduar mirë dhe unë shikoj që është predispozicioni i të gjithë anëtarëve të Këshillit për të përshpejtuar procedurat pa deroguar asnjë detyrim ligjor të pa përmbushur nga ana jonë dhe për këtë pikë, përgëzoj relatorin, por edhe të gjithë kolegët, që po nisim një iniciativë që ka qenë e rrallë në historikun e KLGJ–së, por edhe të ish–KLD–së. Kështu që jam dakord me propozimin. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi, edhe për fjalët!

Dakord.

Kështu që miratohen fillimi i procedurave të transferimit për tre gjyqtaret për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku janë caktuar në mënyrë të përhershme, duke iu propozuar pozicionet në gjykatat përkatëse.

Naureda Llagami: Kalojmë më pas tek grupi tjetër i projekt–akteve që u relatuan në mënyrë të detajuar nga relatori, që kanë të bëjnë me hapjen e procedurave të lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Tiranë për 10 pozicione të lira në fushën e së drejtës civile dhe me një afat kandidimi (se nuk dua të ndalem tek kriteret) deri më datë 1 shkurt 2023. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Hapjen e procedurave të lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për 10 pozicione të lira, në fushën e së drejtës civile, me afat kandidimi deri më datë 1 shkurt 2023.

Naureda Llagami: Kalojmë në grupin tjetër të projekt–akteve që kanë të bëjnë edhe këto me lëvizjet paralele, ku prapë nga Komisioni vjen propozimi për hapjen e procedurave të lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për 4 pozicione të lira, në fushën e së drejtës civile. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për 10 pozicione të lira (*lapsus*, *pasi bëhet fjalë për 4 pozicione*), në fushën e së drejtës civile, edhe këto me afat kandidimi deri më datë 1 shkurt 2023.

Naureda Llagami: Kalojmë në hapjen e procedurave të transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e

kërkesave për kandidatura për 6 pozicione në këtë gjykatë, me afat kandidimi po data 1 shkurt 2023. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Hapjen e procedurave të transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për 6 pozicione, dhe shpalljen e kërkesave për kandidatura me afatin e paraqitjes së tyre deri më datë 1 shkurt 2023.

Naureda Llagami: Kalojmë në hapjen e procedurave të transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shpalljen e kërkesave për kandidatura për 2 pozicione, me një afat kandidimi deri më datë 1 shkurt 2023.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për 2 pozicione, dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura, afati i paraqitjes së të cilave duhet të jetë deri më datë 1 shkurt 2023.

Naureda Llagami: Me kaq përfunduam projekt–aktet të cilat kishin të bënin me masat që do të marri Këshilli.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtares {...} dhe përsëritjen e mandatit të komandimit me 3 (tre) vite", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:34 dhe mbaroi në orën 13:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
7. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
8. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zoti Ridvan Hado***, ***zoti Dritan Hallunaj*** dhe ***zonja Marçela Shehu***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Maela Alicanaj dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

6. Të tjerë: Greta.

7. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtares {...} dhe përsëritjen e mandatit të komandimit me 3 (tre) vite", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt–akti i fundit për mbledhjen e sotshme që ka të bëjë me konfirmimin si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë, të gjyqtares {...} dhe përsëritjen e mandatit të komandimit me 3 vjet.

Për më shumë detaje, prapë fjalën ia jap zotit Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Në Këshillin e Lartë Gjyqësor me anë të shkresës nr. {...} prot., datë 11.10.2022, protokolluar pranë KLGJ–së me nr. {...} prot., datë 13.10.2022, Gjykata e Lartë ka kërkuar konfirmimin për një periudhë 3–vjeçare të ndihmësmagjistrates {...}, si i komanduar në Gjykatën e Lartë.

Në këtë shkresë, theksohet se në kushtet që aktualisht rezulton që Gjykata e Lartë ka vetëm 5 ndihmësmagjistratë të komanduar, ndërkohë që në referim të nenit 34, pika 4 të ligjit nr. 98/2016, më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë të njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë duhet të përbëhet nga ndihmës-magjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë vlerëson të nevojshme që Këshilli i Lartë Gjyqësor të vendosë konfirmimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë, duke përsëritur komandimin e saj për një periudhë 3-vjeçare.

Në analizë të kërkesës së paraqitur nga Gjykata e Lartë, relatori u mbështet në kushtet dhe kriteret për këtë figurë të posaçme të komandimit të parashikuara në nenin 56 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, ku parashikohet se:

"1 – Magjistrati mund të komandohet në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese dhe Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme me mandat pesëvjeçar, me të drejtë ripërsëritje, me kërkesë të institucionit ku komandohet magjistrati.

2 – Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ose i Gjykatës së Lartë, tre muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit të një ndihmësmagjistrati, mund t'i paraqesë Këshillit kërkesë me shkrim për konfirmimin e ndihmësmagjistratit si i komanduar në Gjykatën Kushtetuese ose Gjykatën e Lartë. Këshilli konfirmon ndihmësmagjistratin nëse është vlerësuar të paktën "shumë mirë" në vlerësimin etik dhe profesional, si dhe nëse ndihmësmagjistrati ka dhënë pëlqimin për konfirmim."

Përcaktimet e pikës 2, të këtij neni, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim, për kërkesën respektive të Prokurorisë së Përgjithshme drejtuar Këshillit ... etj., etj..

Nga aktet e administruara në dosjen personale të gjyqtares, rezulton se znj. {...} është caktuar për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me dekretin e Presidentit të Republikës nr. {...}, datë 31.10.2014. Pas përfundimit të stazhit profesional dhe vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës, me dekretin nr. {...}, datë 23.06.2016 znj. {...} është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, detyrë të cilën e ka ushtruar efektivisht deri në muajin janar 2017, pasi më pas

për shkaqe shëndetësore ka përfituar leje të paguar nga skema e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore.

Ish–Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 4 datë 18.01.2018, ka vendosur komandimin e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, {...}, si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë për një periudhë 5–vjeçare. Komandimi i kësaj gjyqtareje është bërë bazuar në nenet 53, 54, 56 në pikën 4 neni 160 të ligjin nr. 96/2016, sipas të cilit periudha prej 5 vitesh ishte periudha maksimale e komandimit. Si e tillë, kjo periudhë komandimi pranë Gjykatës së Lartë përfundon më datë 18.01.2023.

Figura e ndihmesmagjistratit në njësinë e shërbimit ligjor të Gjykatës së Lartë risi e nenit 34 të Ligjit Nr. 98/2016 është krijuar me qëllimin ligjor për të ushtruar veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë duke përfshirë: a) analizimin e praktikës gjyqësore përkatëse mbi interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në gjykim; b) analizimin e çështjes dhe përmbledhjen e procedurës; c) kryerjen e detyrave të tjera për përpunimin e çështjes siç kërkohet nga gjyqtarët. Dallimi kryesor i kategorisë së ndihmësmagjistratëve si magjistratë të komanduar në krahasim me të tjerët, qëndron pikërisht tek natyra e shërbimit ligjor që ai ka në përshkrimin ligjor të punës, pasi në dallim nga të tjerët ai është një figurë "quasi (kuazi)" gjyqësore dhe ndihmon gjithashtu edhe në shkëmbimin e përvojave më të mira reciproke në ekspertimin e ligjit.

Për rrjedhim relatori në mbështetje të dispozitës së sipërcituar analizoi aktet e administruara për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës.

Në referim të nenit 56, pika 2 të ligjit nr. 96/2016 zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, 3 muaj para mbarimit të mandatit të parë, ka paraqitur pranë Këshillit kërkesë me shkrim për konfirmimin e ndihmësmagjistrates znj. {...}, si e komanduar në Gjykatën e Lartë.

Gjithashtu rezulton që znj. {...}, më datë 10.10.2022, ka dhënë pëlqimin për t'u konfirmuar si ndihmësmagjistrat, duke kërkuar përsëritjen e komandimit me tre vite. Sipas vlerësimit të gjyqtares, eksperienca e deritanishme pranë Gjykatës së Lartë, ka qenë e tillë që ka lejuar të kontribuojë në mbarëvajtjen e punës së autoritetit më të lartë gjyqësor dhe njëkohësisht e ka zhvilluar profesionalisht.

Në kuadër të trajtimit të kërkesës së paraqitur për konfirmimin e komandimit të znj. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës me shkresën nr. {...} prot., datë 20.10.2022 i kërkoi një informacion Gjykatës së Lartë lidhur me numrin e përgjithshëm të praktikave gjyqësorë ngarkuar magjistrates gjatë periudhës së komandimit në kuadër të ofrimit të shërbimit të këshilltarit ligjor dhe numrin e përgjithshëm të relacioneve e të analizave praktike të përgatitur nga ana saj, si dhe kopjen e pëlqimit të depozituar nga magjistratja për ripërsëritjen e komandimit, konform nenit 56 paragrafi i dytë i Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve".

Në përgjigjen e ardhur nga Gjykata e Lartë, me shkresën nr. {...} prot., datë 05.12.2022, rezultoi se znj. {...} ka trajtuar një numër prej 599 praktika gjyqësore dhe relacione të ngarkuara magjistrates gjatë periudhës së komandimit 2018-2020 në kuadër të ofrimit të shërbimit të këshilltarit ligjor. Në përgjigje janë bashkëlidhur dhe disa kopje relacionesh të përgatitura nga ana e saj, si edhe pëlqimi me shkrim i gjyqtare për vijimin e komandimit.

Në kushtet kur për përsëritjen e komandimit, në nenin 56, pika 2 të ligjit nr. 96/2016 përcaktohet se: "2. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ose i Gjykatës së Lartë, tre muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit të një ndihmësmagjistrati, mund t'i paraqesë Këshillit kërkesë me shkrim për konfirmimin e ndihmësmagjistratit si i komanduar në Gjykatën Kushtetuese ose Gjykatën e Lartë. Këshilli konfirmon ndihmës magjistratin nëse është vlerësuar të paktën "shumë mirë" në vlerësimin etik dhe profesional, si dhe nëse ndihmësmagjistrati ka dhënë pëlqimin për konfirmim.".

Më datë 18 tetor 2022 është investuar Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në Këshillin e Lartë Gjyqësor për vlerësimin etik dhe profesional të znj. {...}, pasi kriteri ligjore për pranueshmërinë e kërkesës përcakton minimumin nivelin "shumë mirë" të saj.

Me Vendimin nr. 7, datë 18.01.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi "Raportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2018-2020, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë", duke e vlerësuar atë në nivelin e përgjithshëm të vlerësimit "Shkëlqyeshëm" dhe në këtë rast nga ana e

relatorit është kërkuar dhe konfirmim në lidhje me pëlqimin apo dakordësinë në lidhje me këtë vlerësim dhe nga magjistratja, në rrugë elektronike (me postë elektronike) ka konfirmuar marrjen dijeni të këtij vendimi dhe nuk ka kundërshtim për vendimin dhe nuk do të ushtrojë të drejtën e ankimit. Pra është dakord edhe me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke plotësuar kështu një nga kriteret e kërkuara nga ligji për vijueshmërinë e komandimit.

Më tej në kuadër edhe të analizës së moscenimit të interesit publik të cilën Këshilli i Lartë Gjyqësor, si Institucion Publik i pavarur, në kuptim të nenit 147/a të Kushtetutës është i detyruar të mbrojë, relatori përveç vlerësimit të kontributit të magjistrates pranë Gjykatës së Lartë me anë të vendimmarrjeve të saj ka administruar edhe ngarkesën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, ngarkesa e cila deri në shtator të vitit 2022 (të dhëna që janë marrë nga sektorë të brendshëm të KLGJ-së) paraqitet si vijon. Në formë tabelare ju kam dhënë një paraqitje të ngarkesës së kësaj gjykate e cila në total ka 595 çështje në shqyrtim; numri i çështjeve të gjykuara 875 dhe çështje të reja të regjistruara nga data 1 janar, 1090.

Nga vlerësimi i "ekuilibrimit të drejtë të interesave" rezulton se, vijimi i komandimit pranë Gjykatës së Lartë sjell më shumë dobishmëri dhe efektshmëri shërbimi i magjistrates pranë kësaj të fundit sesa në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Kjo jo vetëm për faktin e rëndësisë së jashtëzakonshme të njësisë së shërbimit ligjor të Gjykatës së Lartë, të cilën ligji e konsideron si një figurë "quasi (kuazi)" gjyqësore, pamundësinë e sistemit për ta plotësuar edhe më shumë me gjyqtarë këtë komponent të Gjykatës së Lartë siç kërkohet nga ligji, numri i madh i jashtëzakonshëm i çështjeve të mbartura vit pas viti për zvogëlimin e të cilave kërkohet detyrimisht shërbimi i ndihmësit ligjor dhe nga ana tjetër marrë në konsideratë vendimin nr.495, datë 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave, ku ka vendosur dhe ka përcaktuar hartën gjyqësore e cila në datën 01.05.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec do të përthithet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, pritshmëria që në një të ardhme të afërm do të emërohen dhe caktohen në pozicione vakante një numër i madh magjistratësh që mbarojnë Shkollën e Magjistraturës duke siguruar në këtë mënyrë vijimin e gjykimeve në këtë gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm. Vlerësimi objektiv i dobishmërisë dhe efektshmërisë si dhe shmangia e

konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre na lejon të konkludojmë se përmbushen të gjitha kriteret ligjore që mundësojnë përsëritjen e komandimit.

Propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës

Bazuar në rrethanat faktike të parashtruara dhe në referim të dispozitave ligjore të sipërcituara, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, vlerëson se kërkesa e paraqitur është në përputhje me përcaktimet e nenit 56 të ligjit nr.96/2016. Kështu, rezulton se: a) ka një kërkesë të motivuar të paraqitur nga kryetari i Gjykatës së Lartë për konfirmimin e ndidhmësmagjistratit znj. {...}, ku referohet dhe nevoja konkrete ; b) kërkesa është paraqitur brenda afatit të përcaktuar nga ligji, tre muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit; c) gjyqtarja {...} ka dhënë pëlqimin për konfirmim; c) "Këshilli ka konfirmuar vlerësimin etik dhe profesional të ndihmësmagjistrates në nivelin "Shkëlqyeshëm", pika 2, neni 56 e ligji nr. 96/2016.

Bazuar sa më sipër, nga ana e Komisionit propozohet dhe është përgatitur projekt-akti, në dispozitivin e të cilës ju propozohet të vendosni:

1. Konfirmimin si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë gjyqtares {...}, duke vendosur përsëritjen e mandatit të komandimit me tre vite.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 19.01.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Lartë si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Toro!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt–aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Konfirmimin si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë gjyqtares {...}, duke vendosur përsëritjen e mandatit të komandimit për tre vite.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 19.01.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Lartë si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen e sotshme.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor